



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

*Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor*  
*Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja*  
*Ministry of Environment and Spatial Planning*

AGJENCIONI PËR MBROJTJEN  
E MJEDISIT TË KOSOVËS

KOSOVSKA AGENCIJA  
ZA ZAŠTITU SREDINE

KOSOVO ENVIRONMENTAL  
PROTECTION AGENCY

---

**INSTITUTI HIDROMETEOROLOGJIK I KOSOVËS**

## **RAPORTI PËR CILËSINË E AJRIT PËR PERIU DHËN NËNTOR - DHJETOR 2016 dhe JANAR 2017**



## Monitorimi i cilësisë së ajrit nga IHMK

Cilësia e ajrit monitorohet përmes sistemit të matjeve automatike që do të thotë se bëhen matje kontinuale pa ndërprerje. Parametrat që monitorohen janë: Dioksidi i sulfurit (SO<sub>2</sub>), Ozoni (O<sub>3</sub>), Dioksidi i azotit NO<sub>2</sub> dhe grimcat e suspenduara në ajër PM10 dhe PM2.5.

Rezultatet e mbledhura nga matjet automatike të parametrave ndotes të ajrit përpunohen, validohen dhe bëhet analiza e tyre për të dhënë një vlersim të gjendjes së cilësisë së ajrit në zonen e monitorimit.

Vlersimi i gjendjes së cilësisë së ajrit bëhet duke bërë krahasimin e vlerave të rezultateve të fituara me vlerat standard të lejuara sipas ligjeve dhe rregulloreve vendore në fuqi dhe sipas directives 2008/50 EC për Ajre të Paster në Evrope.

### Rezultatet e monitorimit për periudhën nëntor-dhjetor 2016 dhe janar 2017

Nga analiza e rezultateve të fituara nga monitorimi automatik i cilësisë së ajrit është konstatuar së gjatë periudhës monitoruese Nëntor - Dhjetor 2016 dhe Janar 2017 janë paraqitë tejkalime të vlerave kufitare ditore me PM10. Vlera kufitare ditore e lejuar për mbrojtjen e shëndetit të njeriut është 50µg/m<sup>3</sup>. Ndërsa sa i përket ditëve me tejkalime e lejon të kemi deri në 35 ditë me tejkalime të PM10.

Gjatë tërë këtyre mujve janë regjistruar 46 ditë (raste ) me tejkalime mbi vlerat e lejuar të PM10. Në muajin Nëntor 10 ditë (raste ), në muajin Dhjetor 21 ditë (raste ), dhe në Janarë 15 ditë (raste ). Vlera maksimale është regjistru 254.9µg/m<sup>3</sup>, me datë 29.01.2017. (Shih figurat në vazhdim).




Fig. 1 Përqëndrimi për orë të PM10 dhe PM2.5 në Nëntor 2016, Prishtinë




Fig.2 . Mesatarja ditore e PM10 dhe PM2.5 në Nëntor 2016, Prishtinë




Fig. 3. Përqëndrimi për orë të PM10 dhe PM2.5 në Dhjetor 2016, Prishtinë




Fig. 4. Mesatarja ditore e PM10 dhe PM2.5 në Dhjetor 2016, Prishtinë




Fig. 5. Përqëndrimin për orë të PM10 dhe PM2.5 në Janar 2017, Prishtinë




Fig. 6. Mesatarja ditore e PM10 dhe PM2.5 në Janar 2017, Prishtinë

**Tabela 1: Paraqet ditet me tejkalime për vitet 2015-2016**

PM10 -numri i ditëve që tejkalon vlerën kufitare ditore për 2015, 2016		
Numri i lejuar i ditëve të tejkaluara brenda vitit	35 dite	
Vlera kufitare ditore	50µg/m3	
Numri i ditve me tejkalime brenda vitit, Prishtinë – IHMK	<b>2015</b>	<b>2016</b>
	73 dite	53 ditë
Nëntor	20 dite	10 ditë
Dhjetor	23 dite	21 ditë
Janar	Nuk ka të dhena të mjaftushme	19 ditë
Mesatare vjetor vjetore e <b>PM2.5</b>	<b>30.18</b>	<b>27.81</b>
Mesatare vjetore vjetore e <b>PM10</b>	<b>40.38</b>	<b>30.0</b>

Ndersa në muj Janar të keti viti 2017 kemi pas gjithesejt 15 dite me tejkalime të PM10.

Në vitin që lam pas në kemi regjistru gjithesejt **53** dite (raste) me tejkalime qe do të thot së në kemi pas **18** dite mbi standarte e lejuar. Por krahasuar me vitin 2015 në kemi një përmirsim të cilesise se ajrit, pasi që në vitin e cekur me larte kemi pasë **73** dite me tejkalime të PM10.

Vlerësimi i përqendrimit të grimcave PM 2.5 në përputhshmëri me standardet e kualitetit të ajrit bëhet duke u bazuar në vlerën vjetore e cila është 25µg/m<sup>3</sup>. Gjatë vitin 2016 mesatarja vjetore ka arritur vlerën 27.81 µg/m<sup>3</sup>, që është mbi vlerat e lejuara.

Përqendrimit e ndotësve tjerë të gaztë sikur janë SO<sub>2</sub>, CO, NO<sub>2</sub> dhe O<sub>3</sub> nuk kanë tejkaluar vlerat kufitare të lejuara, por megjithatë në krahasim me muajt e tjerë të vitit, gjatë muajve Nentor, Dhjetor 2016 dhe Janar 2017, ka pasur një ngritje të vlerave mesatare.

## Konkluzione dhe Rekomandime

- Nga analiza e rezultateve të larte përshkruara mund të përfundohet se përqendrimit e larta të PM<sub>10</sub> dhe PM<sub>2.5</sub> bëjnë që cilësia e ajrit në Prishtinë të jete jo e kënaqshme.
- Kësaj gjendje i kontribuojnë shkarkimet e ndotësve nga burimet, siq janë industria, transporti dhe konsumimi i lendeve të ngurta djegëse që përdoren për ngrohje si dhe kushtet e pafavorshme për disperzionin e ndotjes që emetohet në ajër.
- Gjate këtyre muajve për të cilat jemi duke shqyrtuar gjendjen e cilësisë se ajrit në Prishtinë ka mbretëruar një mot me mjegull të dendur (dukshmëri <30 m) dhe lagështi të larte të ajrit mbi 85% si dhe mungese e erës dhe kur këtyre kushteve u shtohen edhe shkarkimet e ndotësve në ajër atëherë vije deri të krijimi i gjendjes se smogut (i thirrur smogu i Londrës) që është karakteristik për paraqitjen e tije gjate sezonit dimërore Nëntor - Dhjetor- Janar dhe i cili shkakton eksitim të bronkieve dhe kollitje.
- Në këto raste rekomandohet që kategoria e ndjeshme (personat me probleme nga sëmundjet e organeve respiratorë të mos qëndrojnë gjate në ambiente të tilla.